



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 3181

Tirane, date 9.4.2015

Drejtuar: ZOTIT SAHI ÇELIK
SHOQERIA "TETE ALBANIA TUNNEL & MINING" SH.P.K
RRUGA "DON BOSKO" PALLATI NOKA,
APARTAMENTI 5, KATI I DYTE, NR.12

TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr.1068 date 20.08.2007.

I nderuar zoti Çelik,

Shoqëria "Tete Albania Tunnel & Mining" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1068 date 20.08.2007, për mineral bakri ne objektin "Spaç" Mirdite, ne Qarkun Lezhe.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" i ndryshuar, i cili është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve te tij edhe për lejet e dhëna përpara datës se hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Me Urdhrin Nr.546, date 25.07.2011, te Ministrit te Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është revokuar leja minerare nr. 1068, date 20.08.2007 qe i përket kompanisë " Tete Albania Tunnel & Mining" SH.P.K.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane merr vendim për pezullimin e zbatimit te Aktit Administrativ, Urdhër Nr.546, date 25.07.2011, dhe me pas,

Gjykata e Apelit Tirane, ka lënë në fuqi këtë Vendim te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor te Tiranës me Nr.2967, date 18.12.2012.

Shoqërisë "Tete Albania Tunnel & Mining" sh.p.k me Urdhër Nr.230, date 26.06.2014 te Ministrit te Energjisë dhe Industrisë dhe shkresën nr. 1650/2, date 11.07.2014 i është riaktivizuar leja minerare nr. 1068, date 20.08.2007.

Me urdhër të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 60 date 03.03.2015 “Për kontrollin e aktivitetit të subjektit “Tete Albania & Tunnel, qe zhvillon aktivitet minerar ne shfrytëzimin e mineralit te bakrit ne objektin Spaç, Mirdite” është ngritur grupi i punës i përberë nga specialiste të Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Minierave pranë kësaj ministrie, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, i cili ka kryer kontrollin ne objektin e përcaktuar ne Urdhrin ne fjale me date 16 dhe 17 mars te vitit 2015.

Pas kontrollit është hartuar raporti për objektin përkatëse, ne zbatim të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë” te ndryshuar dhe akteve nënligjore qe kane dale ne zbatim te tij.

Grupi i Punës ka propozuar te revokohet leja minerare nr.1068 date 20.08.2007, qe zotërohet nga shoqëria “Tete Albania Tunnel & Mining” shpk, pasi shoqëria “Tete Albania Tunnel & Mining” sh.p.k nuk ka filluar pune për me shume se 180 dite, nga hyrja ne fuqi e lejes, ne rastin konkret nga riaktivizimi i saj, duke shkelur paragrafin ii te pikës 1/b te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar. Shkaku qe cituam me sipër është shkak ligjor, për te cilën një leje revokohet.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr.1068 date 20.08.2007, për mineral bakri ne objektin “Spaç” Mirdite, ne Qarkun Lezhe.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes nr.1068 date 20.08.2007.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

